



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2024:034719

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05625234

PML.nr.256/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rasim Rasimi kryetar kolegji, Agim Maliqi dhe Mejreme Memaj anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, në çështjen penale kundër të pandehurve D. H. dhe I. I. për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale keqpërdorimi i detyrës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par. 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit D. H. av. Berat Tmava dhe për të pandehurin I. I. av. Driton Muharremi, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, Ppr.Kr.nr.14/2024 të datës 28.3.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.1.nr.295/2024 të datës 5.4.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 25.4.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të pandehurve D. H. dhe I. I., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, Ppr.Kr.nr.14/2024 të datës 28.3.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.1.nr.295/2024 të datës 5.4.2024.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktvendimin Ppr.Kr.nr.14/2024 të datës të datës 28.3.2024, të pandehurve D. H. dhe I. I. për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale keqpërdorimi i detyrës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK, ua ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji e cila masë do t'iu zgjasë deri me datën 29.4.2024. Masa e paraburgimit iu është vazhduar në bazë të nenit 184 par.1 nën par.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN.1.nr.295/2024 të datës 5.4.2024, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të pandehurve dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë ushtruar:

mbrojtësi i të pandehurit D. H. av. Berat Tmava, për shkak të shkeljes së dispozitës së nenit 184 par. 1 nën par. 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.2 të KPP, nenit 182 par.2 të KPP dhe nenit 6 të KEDNJ, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës aktvendimin e kundërshtuara t'i ndryshojë dhe të pandehurit t'ia ndërpresë paraburgimin ose aktvendimet t'i anulojë dhe çështjen ta kthejë në rivendosje, dhe

mbrojtësi i të pandehurit I. I. av. Driton Muharremi, për shkak të shkeljes së dispozitës së nenit 184 par. 1 nën par. 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.2 të KPP, nenit 432 par. 1 dhe 4 lidhur me nenin 384 par. 2 pika 2.1 dhe 2.2 të KPP dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës aktvendimet e kundërshtuara t'i ndryshojë dhe të pandehurit t'ia ndërpresë paraburgimin ose aktvendimet t'i anulojë dhe çështjen ta kthejë në rivendosje.

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.111/2024 të datës 24.4.2024, ka propozuar që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësve të të pandehurve të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesave, dhe gjeti se:

- kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk janë të bazuara.

Në kërkesa për mbrojtjen të ligjshmërisë mbrojtësit theksojnë se aktvendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë përmbajnë shkeljet e dispozitave të procedurës penale pasi që nuk përmbajnë arsyetimin e duhur ligjor sepse nuk ekziston rreziku i ndikimit në dëshmitarë eventuale të cilëve nuk iu dihet identiteti dhe nuk janë cekur. Prokuroria nuk ka identifikuar ndonjë dëshmitarë sepse në të kundërtën do t'i kishte intervistuar deri më tani. I pandehuri D. H. e ka pranuar fajësinë dhe kjo rrethanë është dashur që të vlerësohet.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mësipërme janë të pabazuara, ngase nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, nga kallëzimi penal me numër të rastit R-2024-XI-HK-HEKE-PR-11 2024-KE-14 të datës 30.01.2024, aktvendimit për fillimin e hetimeve, deklaratat e të pandehurve dhe shkresave tjera në lëndë, rezulton dyshimi i bazuar se të pandehurit dyshohet se kanë kryer veprën penale për të cilën dyshohen, kurse a do të argumentohen këto fakte e prova do të vlerësohet në fazat e ardhme të procedurës penale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 184 par. 1 nën par. 1.1. e 1.2. të KPP.

Kjo gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 184 par. 1 nën par. 1.1 e 1.2 pika 1.2.2 të KPP, ngase me lëshimin e të pandehurve në liri ekziston rreziku i ndikimit në të bashkë të pandehurit të njëri tjetri që t'i koordinojnë deklaratat me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale si dhe mundësia e ndikimit të dëshmitarët e tjerë të rastit, e në këtë mënyrë do ta pamundësonin zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur të kësaj baze ligjore dhe në bazë të vlerësimit të tillë kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme lidhur me këtë bazë ligjore, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË
Pml.nr.256/2024, me datë 25.4.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Qefsere Berisha

Kryetari i kolegjit,
Rasim Rasimi